

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"MANDARIN RESTAURANT" SHPK

Sot me daten 01.03.2025 ,themeluesi:

Andon Kristo i biri i Kristo-s ,i datelindjes 21.05.1986, lindur ne Fier,Shqiperi dhe banuese ne Fier,Shqiperi,identifikuar me Nr. ID I60521106E.

Ilrjan Ferko i biri i Elmaz-it ,i datelindjes 13.10.1975, lindur ne Fier,Shqiperi dhe banuese ne Fier,Shqiperi,identifikuar me Nr. ID H51013013S.

Ne perputhje me Ligjin nr.9901 Date 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 date 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Ka vendosur te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar " **MANDARIN RESTAURANT** " Shpk.

Neni 1.

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet " **MANDARIN RESTAURANT** " SHPK

Neni 2

SELIA E SHOOERISE

Selia e shoqerise eshte ne adresen: **Bashkia Fier, Qyteti:Fier, Lagjja 11-Janari ,Rruga Ramiz Aranitasi, Njesia Nr. 6/136, Kati 2, ZK.8531**. Shoqeria mund te hape filiale te tjera ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise si dhe ne te gjitha shtetet jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 3


OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Bar-Restaurant dhe sherbime te ndryshme catering,organizim eventesh te ndryshme.

Neni 4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE



Kapitali themeltar i shoqerise do jete 100.000 (Njeqind mije)Leke.Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e plote me vlere te pergjithshme prej 100.000 leke.Keto kuota i perkasin ortakeve si me poshte:

1. Andon Kristo ID Nr. I60521106E zoterues i 1(kuote) me vlere te pergjithshme 50,000 leke perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Ilirjan Ferko ID Nr. H51013013S zoterues i 1(kuote) me vlere te pergjithshme 50,000 leke perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakut.

Neni 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

Neni 6

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administrator i shoqerise do te jete Z. Andon Kristo ID Nr. I60521106E, e cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte rizgjedhje.Nje Administrator tjeter mund te emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Administratori ka te gjithë kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te trete ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve.

Neni 7

VENDIME TE ASAMBLESE SE PERGJITHESHME

Asambleja e pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres.

Vendimet e asamblese se pergjithshme merren bazuar ne perqindjen e kapitalit e zoteruar prej secilit ortak, konform pikes 1 neni 86 i ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Per shoqerite Tregtare",

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjitheshrne regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur

shoqeria proven se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi do te shperndahet midis ortakeve respektivisht sipas kuotave te kapitalit themeltar te investuar te shprehura ne nenin 4 te ketij akti. Fitimi i destinuar per tu shperndare perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven ligjore dhe te tjera rezerva statutore , si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjet e mbartura nga vitet e meparshme.

Neni 9

LIKUIDIMI

Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj, operacion i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne legjislacionin tregtar shqiptar.

Neni 10

MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, Themeluesi do ti drejtohet Gjykates se Rrethit per zgjidhje.

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“MANDARIN RESTAURANT” Shpk

Ortaket

Andon Kristo



Ilirjan Ferko

